



ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Zgjedhjet parlamentare paraqesin mekanizma demokratikë, me ndihmën e të cilëve zgjidhen deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është organ përfaqësues njëdhomësh i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nëpërmjet këtij mekanizmi populli ia beson ushtrimin e pushtetit politik, organit përfaqësues i cili pastaj e përfaqëson vullnetin e tij sovran. Elektorati e mundëson kalimin e sovranitetit nga qytetarët te përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike.

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi përbëhet nga 120 deri në 140 deputetë. Numri i saktë i deputetëve është përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe ai numër deri në vitin 2008, ishte 120, ndërsa me ndryshimet e tij nga viti 2008 dhe 2015 numri i deputetëve mund të zmadhohet deri në 123.

Parimet themelore të zgjedhjeve parlamentare janë rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa mënyra, kushtet dhe procedurat për zgjedhje të deputetëve janë të rregulluara me Kodin Zgjedhor.

Deputetët marrin mandate 4 vjeçare në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votime të fshehta.

Zgjedhjet parlamentare zhvillohen çdo katër vjet gjatë 90 ditëve të fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve, ndërsa ato i shpall Kryetari i Kuvendit.

Zgjedhjet parlamentare mbahen edhe në rast të vetëshpërbërjes së Kuvendit (zgjedhje të parakohshme), nëse për të deklarohen shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në këtë rast, zgjedhjet zhvillohen, në afat prej 60 ditësh nga dita e shpërbërjes së Kuvendit.

E DREJTA E VOTIMIT

E drejta aktive e votimit

Të drejtë për votim ka çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ka mbushur 18 vjet, ka aftësi për të vepruar dhe ka adresë të përhershme në njësinë zgjedhore, në të cilën ka votime.

Në zgjedhjet për deputetë në Kuvend votojnë edhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët në ditën e zgjedhjeve janë me punë dhe qëndrim të përkohshëm jashtë vendit. Të drejtën për votim ata e realizojnë në përfaqësitë diplomatike konsulllore të Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit. Votimi nuk është i detyrueshëm.

E drejta pasive e votimit

Kandidat për deputet mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ka mbushur 18 vjet, ka aftësi për të vepruar dhe nuk është duke vuajtur dënim me burg për kryerje të veprës penale, përkatësisht nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj, ndërsa ende nuk ka filluar ta vuajë dënimin.

MODELET ZGJEDHORE

Modeli zgjedhor paraqet një përmbledhje të rregullave, në bazë të të cilave votat e elektoratit shndërrohen në mandate deputetësh.

Ekzistojnë dy modele themelore zgjedhore (me variacione të mundshme të ndryshme): modeli zgjedhor i shumicës dhe modeli proporcional zgjedhor.

Sipas modelit zgjedhor të shumicës e drejta e mandatit (vendi në shtëpinë përfaqësuese) i takon kandidatit i cili ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet e mbajtura (shumicë plurale, relative, absolute ose e kualifikuar). Sistemet zgjedhore të shumicës shpeshherë zbatohen në njësitë zgjedhore me një mandat ku votuesit e japin votën për kandidatët, e jo për listat partiake.

Sipas modelit proporcional çdo listë për kandidatë përfaqësohet në shtëpinë përfaqësuese në proporcion me pjesën e votave të fituara nga elektorati, përkatësisht lista për kandidatë merr një përqindje të mandateve përfaqësuese që është proporcional me përqindjen e votave që partia i ka fituar gjatë zgjedhjeve. Modelet proporcionale të zgjedhjeve shpeshherë zbatohen në njësitë zgjedhore me më shumë mandate ku votuesit e japin votën për listat partiake, e jo për kandidatët.

MODELET ZGJEDHORE PARLAMENTARE TË MAQEDONISË (1990 - 2016)

Zgjedhjet e para demokratike shumëpartiake në Republikën Socialiste të Maqedonisë janë zhvilluar më 11 nëntor të vitit 1990, menjëherë pas fillimit të pluralizmit politik në shtator të të njëjtit vit.

Zgjedhjet e para parlamentare janë mbajtur në tetor të vitit 1994, pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991.



Pulla postare e Postës së Maqedonisë me rastin e 20 vjetorit të zgjedhjeve të para shumëpartiake në Maqedoni (FDC 19/2010, 11 nëntor, 2010)

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1990 dhe 1994 shpërndarja e mandateve të deputetëve është bërë sipas modelit zgjedhor të shumicës në dy rrethe, me shumicë absolute (në rrethin e parë) dhe shumicë relative (në rrethin e dytë). Në këto zgjedhje deputetët janë zgjedhur në bazë të parimit: një njësi - zgjedhore një mandat deputeti.

Në vitin 1998 është ndryshuar modeli zgjedhor dhe është zbatuar modeli i kombinuar zgjedhor: 85 deputetë janë zgjedhur sipas modelit të shumicës, ndërsa 35 sipas modelit

proporcional. Njësitë zgjedhore, për 35 mandatet e deputetëve të cilat shpërndahen sipas modelit proporcional është në të gjithë territorin e Republikës. Shpërndarja e mandateve është bërë në bazë të Modelit të Dontit, me prag zgjedhor prej 5%.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 është zbatuar modeli proporcional për ndarjen e të gjitha 120 vendeve të deputetëve, ku territori i Republikës është ndarë në gjashtë njësi zgjedhore, kurse nga çdo njësi zgjedhore zgjidhen nga 20 deputetë. Që të sigurohet përfaqësim më i lartë i grave në Kuvend, për herë të parë është zbatuar kuota prej 30% si garanci për pjesëmarrje të gjinisë e cila është e

përfaqësuar më pak. I njëjti model është përdorur edhe gjatë mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006 dhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008.

Në përputhje me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2008, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2011, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë u zgjodhën 123 deputetë.

Sipas modelit proporcional u zgjedhën 120 deputetë (në gjashtë njësi zgjedhore me 20 deputetë), ndërsa tre deputetë u zgjodhën sipas modelit të shumicës (në një rreth) nga tri njësi zgjedhore në diasporë. Modeli i njëjtë zgjedhor u zbatua edhe në zgjedhjet e treta të parakohshme parlamentare në vitin 2014. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016, në Kuvend u zgjodhën 120 deputetë. Në këto zgjedhje nuk u zgjedhën deputetë nga diaspora sepse nuk u përmbushën kushtet e nevojshme të përcaktuara me ndryshimet e Kodit Zgjedhor nga viti 2015.

Në bazë të këtyre ndryshimeve tre deputetë zgjidhen në një njësi zgjedhore sipas modelit proporcional ku: deputeti i parë zgjidhet nëse lista për kandidatë ka marrë minimum vota sa ka marrë deputeti i zgjedhur me numrin minimal të votave në njësitë zgjedhore në Republikën e Maqedonisë, deputeti i dytë dyfish më shumë, ndërsa deputeti i tretë trefish më shumë vota se deputeti me numër minimal të votave në njësitë zgjedhore në Republikën e Maqedonisë. Nëse në njësinë e shtatë zgjedhore asnjë nga listat nuk i ka marrë votat e nevojshme, nuk zgjidhet asnjë deputet. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor nga viti 2015, kuota si garanci për pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar është zmadhuar në 40%.

KANDIDATËT PËR DEPUTETË

Propozimi i kandidatëve për deputetë bëhet me dorëzimim e listës së kandidatëve për deputetë. Të drejtën e dorëzimit të listës së kandidatëve për deputetë e kanë partitë politike të regjistruara në mënyrë të pavarur, si koalicion, ose si grup votuesish.

Kur parashtresi i listës së kandidatëve për deputetë është grup votuesish, është e nevojshme që të mbledhen minimum 1.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në Listën zgjedhore të njësisë zgjedhore.

FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore është paraqitja publike e kandidatëve dhe e programeve të tyre gjatë periudhës parazgjedhore, me qëllim që të ndikohet mbi vendimin e zgjedhësve gjatë votimit (evenimente publike, shfaqja publike e afisheve, video prezantime në vende publike, paraqitja në media dhe në internet, shpërndarja e materialeve të shtypura).

Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve.

Organizatorët e fushatës zgjedhore kanë të drejtë që në kushte të njëjta t'i përdorin të gjitha llojet e propagandave politike. Gjatë fushatës zgjedhore Servisi Publik Radiodifuziv është i detyruar të transmetojë falas paraqitjen politike të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

VOTIMI

Votimi për zgjedhjet parlamentare fillon në ora 7,00 të mëngjesit dhe vazhdon pandërprerë deri në ora 19,00.

Zgjedhësit të cilët në ditën e votimit janë përkohësisht me punë ose banim jashtë vendit votojnë në përfaqësitë diplomatike-konsullore, një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Votimi mbahet në të njëjtin interval kohor nga ora 7,00 deri 19,00, sipas llogaritjes së kohës në vendin përkatës. Një ditë para zgjedhjeve votojnë edhe personat të cilët janë në paraburgim ose vuajnë dënimin me burg, si dhe të zhvendosurit brenda shtetit, të sëmurët dhe personat e paaftë.

MBLEDHJA E REZULTATEVE DHE NDARJA E MANDATEVE TË DEPUTETËVE

Rezultatet përfundimtare të votimit i vërteton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, veç e veç për çdo njësi zgjedhore.

Në shtatë njësitë zgjedhore shpërndarja e mandateve të deputetëve bëhet duke zbatuar formulën e Dontonit, kështu që për zgjedhjen e deputetëve në njësinë e shtatë zgjedhore duhet të përmbushen disa kushte të përshkruara më lartë.

Formula e llogaritjes është:

$$\frac{V}{s + 1}$$

V paraqet numrin e përgjithshëm të votave të cilat i ka fituar lista zgjedhore, ndërsa S paraqet numrin e mandateve/vendeve të cilat i ka fituar lista (në fillim 0 për të gjitha listat, ndërsa procedura përsëritet deri në ndarjen e mandateve).

Sipas Sistemit të Dontit, numri i votave nga çdo listë zgjedhore ndahet me 1, 2, 3, 4.....n (n është numri i vendeve të deputetëve në njësinë

zgjedhore). Herësit e fituar renditen sipas madhësisë së tyre, ku merren parasysh herësit më të mëdhenj për mandatet që janë në njësinë zgjedhore. Çdo listë fiton aq mandate, sa ka herës më të lartë në votat e fituara. Mandatet ndahen sipas renditjes së kandidatëve të listës.

Për shembull, të supozojmë se gjatë zgjedhjeve në një njësi zgjedhore, në të cilën zgjidhen gjashtë përfaqësues, marrin pjesë katër lista partiake. Lista A ka fituar 330.898 vota, lista B 212.512, lista C 154.926 dhe lista Ç 99.730 vota. Rezultatet zgjedhore në secilën listë ndahen me 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Lista A

$$\begin{aligned} 330.898:1 &= 330.898 \\ 330.898:2 &= 165.449 \\ 330.898:3 &= 110.299 \\ 330.898:4 &= 82.724 \\ 330.898:5 &= 66.179 \\ 330.898:6 &= 55.149 \end{aligned}$$

Lista B

$$\begin{aligned} 212.512:1 &= 212.512 \\ 212.512:2 &= 106.256 \\ 212.512:3 &= 70.837 \\ 212.512:4 &= 53.128 \\ 212.512:5 &= 42.502 \\ 212.512:6 &= 35.418 \end{aligned}$$

Lista C

$$\begin{aligned} 154.926:1 &= 154.926 \\ 154.926:2 &= 77.463 \\ 154.926:3 &= 51.642 \\ 154.926:4 &= 38.731 \\ 154.926:5 &= 30.985 \\ 154.926:6 &= 25.821 \end{aligned}$$

Lista Ç

$$\begin{aligned} 99.730:1 &= 99.730 \\ 99.730:2 &= 49.856 \\ 99.730:3 &= 33.243 \\ 99.730:4 &= 24.932 \\ 99.730:5 &= 19.946 \\ 99.730:6 &= 16.621 \end{aligned}$$

Nga të gjitha rezultatet, rezultati i gjashtë sipas madhësisë është 106.256, që njëkohësisht është edhe pjesëtues i përbashkët me të cilin ndahen rezultatet e përgjithshme nga çdo listë, edhe atë:

$$\begin{aligned} \text{Lista A} &- 330.898:106.256 = 3 \\ \text{Lista B} &- 212.512:106.256 = 2 \\ \text{Lista C} &- 154.926:106.256 = 1 \\ \text{Lista Ç} &- 99.730:106.256 = 0 \end{aligned}$$

Nga shembulli rezulton se partia A do të fitojë tri mandate, partia B do të fitojë dy mandate, partia C një mandat, ndërsa partia D nuk do të fitojë asnjë mandat.

Zgjedhjet parlamentare '94	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
LSDM etj.	87
PPD	10
PDP	4
PDM	1
Kandidatë të pavarur	6
PEPR	2
PL	5
LSDM	1
PSDM	1
PSM	1
PAD-PDTM	1
LSDM-PL	1
Gjithsej	120

Zgjedhjet parlamentare '98	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE	49
LSDM	27
PPD-PDP	25
PLD-PDM	4
PSM	1
AD	13
LRM	1
Gjithsej	120

Zgjedhjet parlamentare '02	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
LSDM etj.	60
VMRO-DPMNE - PL	33
BDI	16
PDSH	7
PPD	2
PDP	1
PSM	1
Gjithsej	120

Zgjedhjet parlamentare '06	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE etj.	45
LSDM etj.	32
BDI etj.	17
PDSH	11
PSDR	7
VMRO-PP	6
DOM	1
PAE	1
Gjithsej	120

Zgjedhjet parlamentare '08	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE etj.	63
LSDM etj.	27
BDI	18
PDSH	11
PAE	1
Вкупно	120

Zgjedhjet parlamentare '11	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE etj.	56
LSDM etj.	42
BDI	15
PDSH	8
RDK	2
Gjithsej	123

Zgjedhjet parlamentare '14	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE etj.	61
LSDM etj.	34
BDI	19
PDSH	7
RDK	1
GROM	1
Gjithsej	123

Zgjedhjet parlamentare '16	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE etj.	51
LSDM etj.	49
BDI	10
Lëvizja BESA	5
Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët"	3
PDSH	2
Gjithsej	120

Zgjedhjet parlamentare '20	
Entiteti politik	Numri i mandateve të fituara
VMRO-DPMNE etj.	46
LSDM etj.	44
BDI	15
Aleanca për Shqiptarët /Alternativa	12
E Majta	2
PDSH	1
Gjithsej	120

Lista e shkurtoreve

- VMRO-DPMNE** - VMRO Partia Demokratike për Unitet Nacional Maqedonas
- LSDM** - Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
- BDI** - Bashkimi Demokratik për Integrim
- PDSH** - Partia Demokratike Shqiptare
- PLD** - Partia Liberal Demokratike
- PSM** - Partia Socialiste e Maqedonisë
- PAE** - Partia për Ardhmëri Evropiane
- PPD** - Partia për Prosperitet Demokratik
- RDK** - Rilindja Demokratike Kombëtare
- AD** - Alternativa Demokratike
- GROM** - Opsioni Qytetar për Maqedoni
- DOM** - Rimëkëmbja Demokratike e Maqedonisë
- PEPR** - Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve
- PSDR** - Partia Socialdemokrate e Re
- PL** - Partia Liberale
- PDM** - Partia Demokratike e Maqedonisë
- PSDM** - Partia Socialdemokrate e Maqedonisë
- PAD** - Partia për Aksion Demokratik
- PDTM** - Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë
- VMRO-PP** - VMRO Partia Popullore
- LRM** - Lidhja e Romëve në Maqedoni



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTJETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

IMPLEMENTUAR NGA:



Ky publikim është përgatitur nga Instituti Parlamentar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PSP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për menaxhimin e ndryshimeve (CMP). Përbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e SDC.